


Emancipimi Civil Ma Ndryshe



Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit të Pavarur

31 DHJETOR 2024

(Ky raport përmban 15 faqe)

Përmbajtja

Raporti i Auditorit të Pavarur.....	3-5
Pasqyra e pozicionit financiar	6
Pasqyra e të Ardhurave dhe Fondeve të Shfrytëzuara	7
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet.....	8
Shënimet e Pasqyrave Financiare	9-15

Raporti i Auditorit të Pavarur

Për Menaxhmentin e OJQ Emancipimi Civil Ma Ndryshe, Prishtinë

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare OJQ Emancipimi Civil Ma Ndryshe (më tej si OJQ "EC Ma Ndryshe") që përbëhet nga: pasqyra e pozicionit financiar në datën 31 Dhjetor 2024, pasqyra e të ardhurave dhe fondeve të shfrytëzuara për periudhën 1 Janar 2024 deri më 31 Dhjetor 2024 si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt në të gjitha aspektet materiale pozicionin financiar të Organizatës me datën 31 Dhjetor 2024, si dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Informacione të tjera të ndryshme nga Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Audituesit mbi to

Menaxhmenti është përgjegjës për informacionet e tjera. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se janë me anomali materiale. Nëse, bazuar në punën e kryer, ne arrijmë në përfundimin se në këto informacione ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që Menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, Menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion nëse është e zbatueshme për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur Menaxhmenti synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit.

Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.

- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionit mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga Menaxhmenti.

-Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

-Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

-Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

-Ne gjithashtu, ju japim personave të ngarkuar me qeverisjen një deklaratë që ne jemi në pajtim me kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe ju komunikojmë atyre të gjitha lidhjet dhe çështjet e tjera që mundet në mënyrë të arsyeshme, të ndikojnë në pavarësinë tonë, dhe kur është e zbatueshme, masat mbrojtëse përkatëse.

-Nga çështjet e komunikuara personave të ngarkuar me qeverisjen, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishmet për auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe për pasojë edhe çështje kryesore të auditimit. Ne i përshkruajmë këto çështje në raportin tonë të auditimit përveç nëse në rastin kur ligji ose rregullat e ndalojnë bërjen publike të çështjes ose kur, në raste jashtëzakonisht të rralla, ne vendosim që çështja të mos komunikohet në raportin tonë për arsye se pasojat negative nga një komunikim i tillë pritet në mënyrë të arsyeshme të tejkalojnë përfitimet në favor të interesit publik.

"ETIKA CO"

Fatmir MEHMETI – Auditor Ligjor



Rruga " Tirana " Hyrja F, Nr 23, Prishtinë

Republika e Kosovës

25.04.2025

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
Me 31 dhjetor 2024

PASURITË	Shënimi	Më 31.12.2024	Më 31.12.2023
		€	€
Pasuritë qarkulluese			
Paraja dhe ekuivalentet e saj		70,954	89,147
Parapagimet			
Llogari te Arketushme		-	-
Totali i pasurive qarkulluese		70,954	89,147
Pasuritë jo qarkulluese			
Prona, impiantet dhe paisjet			
Paisjet tjera			
Total pasurive jo-qarkulluese		-	-
TOTAL PASURITË		70,954	89,147
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurta			
Llogari te pagushme			
Të hyrat e shtyra		70,954	89,147
Total Detyrimet afatshkurta		70,954	89,147
Fondet			
Fondet/mungesat e bartura			
Rezervat tjera			
Teprica/mungesa e vitit		-	-
Total Fondet		-	-
Total Detyrimet dhe Fondet		70,954	89,147

Të autorizuar nga menaxhmenti me date 25 Mars 2025:

Valon Xhabali


Drejtör Ekzekutiv



Admir Istrefi


Menaxher i financave

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE
Për periudhën 01/01/2024 deri 31/12/2024


		Për periudhën 2024 €	Për periudhën 2023 €
	Shënime		
Të hyrat			
Të hyrat nga donacionet	5	339,831	276,281
Totali i të hyrave		339,831	276,281
Shpenzimet			
Shpenzimet projektit	6	239,865	187,717
Shpenzimet pagave	7	80,897	71,269
Shpenzimet administrative	8	7,038	8,500
Shpenzimet e qirasë	9	7,645	7,135
Provizionet	10	770	800
Shpenzimet e auditimit		3,615	860
Totali i shpenzimeve		339,831	276,281
Teprica/(Mungesa) për vitin		-	-

Të autorizuar nga menaxhmenti me date 25 Mars 2025:

Valon Xhabali

Drejtör Ekzekutiv



Admir Istrefi

Menaxher i financave

Emancipimi Civil Ma Ndryshe "EC Ma Ndryshe"
Pasqyrat Financiare, Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2024

Pasqyra e e ndryshimeve në ekuitet për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024

	Fondi	Teprica e mbajtur e fondeve	Totali
	(në EURO)	(në EURO)	(në EURO)
Më 01 Janar	-		-
Rezervat e tjera			
Suficidi/Deficiti i fondeve	-	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2023	-	-	-
Më 01 Janar	-		-
Rezervat e tjera	-		
Suficidi/Deficiti i fondeve	-	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2024	-	-	-

Shënime të pasqyrave financiare

1. Të përgjithshme

OJQ Emancipimi Civil Ma Ndryshe ("EC Ma Ndryshe"), është e themeluar në vitin 2006 me numër fiskal 600523783, dhe Adrese: ZEKI SHULEMAJA NR. 2. EC është organizatë e komunitetit që angazhohet për avancimin e demokracisë në nivel lokal në Kosovë. Organizata punon me një numër të konsiderueshëm grupesh të komunitetit, si dhe mirëmban një presion të përhershëm ndaj qeverive lokale për qeverisje gjithëpërfshirëse, transparente dhe llogaridhënëse. EC angazhohet për qytetari aktive në formësimin e ambientit jetësor duke nxitur organizim të mirëfilltë të komunitetit, demokratizim të institucioneve dhe pasurim të jetës kulturore në qendrat kryesore të Kosovës, me fokus në Prizren dhe Prishtinë. Nga janari i vitit 2015, EC funksionon me këto tri programe: Qyteti Gjithëpërfshirës (mobilizim i komunitetit), Qeverisja e mirë (monitorim dhe avokim), Hulumtimi (prodhim i dijes).

Tiparet dalluese të EC janë: një, fokusi gjeografik, dhe dy, qasja ndaj çështjeve të interesit. E bazuar në Prizren dhe Prishtinë, organizata përdor qasje antropologjike në hulumtimin dhe zhvillimin e politikave. Si rezultat, produktet e hulumtimit të organizatës ofrojnë përmbajtje të besueshme, pasi që merren me thelbin e problemit në vend se me simptomat. Për më tepër, EC mbulon fusha të veçanta sikur planifikimi urban, politikat kulturore, menaxhimi i hapësirës publike dhe të ngjashme, të cilat janë përgjithësisht të nën trajtuara në Kosovë. Aktiviteti hulumtues dhe aktivizmi grassrootsi organizatës janë metoda pune të kombinuara mirë dhe të ndërvarura. Përmes aktivizmit, EC angazhohet në mënyrë të përhershme në punë me grupet e komunitetit për t'i identifikuar nevojat e tyre, të cilat janë burime që e ushqejnë komponentën e hulumtimeve. Kjo metodologji mundëson ndikim më të madh tek agjenda e politikë bërjes, pasi që idetë vijnë nga poshtë, ndërsa paralelisht krijohen mundësi për përfshirjen e politikë bërësve në një debat konstruktiv dhe të mirë informuar.

EC Ma Ndryshe është ndër themelueset dhe përfaqëson Kosovën në Rrjetin e Europës Juglindore të organizatave që merren me trashëgimi kulturore – SEE Heritage Network. Gjithashtu, është themeluese e Forumit të Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit, Rrjetit të Organizatave të Kulturës në Prizren dhe Rrjetit të Organizatave të Pavarura të Kulturës në Kosovë – Forumi Kulturor.

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE DHE POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL

2.1. Baza e përgatitjes

2.1.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kontabilitetit në bazë të keshit për të hyrat dhe shpenzimet. Bazat e matjes janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në politikat e kontabilitetit të paraqitura më poshtë

2.1.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare për organizatën janë përgatitur mbi bazën e kostos historike. Kostoja historike në përgjithësi bazohet në vlerën e drejtë të vlerës së dhënë në këmbim të të mirave dhe shërbimeve.

2.1.3. Valuta funksionale dhe e prezantimit

Valuta funksionale e organizatës si dhe e prezantimit të pasqyrave financiare është Euro ("EUR"), e cila

është valuta kryesore në Republikën e Kosovës që nga 1 janari 2002.

2.1.4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me ligjet aktuale në fuqi, kërkon që menaxhmenti të bëjë vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shifrat e raportuara të pasurive dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen mbi baza të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

2.1.5. Parimi i vijueshmërisë

Pasqyra e pozicionit financiar dhe ajo e të ardhurave gjithëpërfshirëse, janë përgatitur mbi parimin e vijueshmërisë, që supozon se organizata do të jetë në gjendje të realizojë pasuritë e saj dhe t'i mbulojë detyrimet, gjatë rrjedhës normale të operimit.

2.2. Politika të rëndësishme kontabël

2.2.1 Paraja dhe ekuivalentët e parësë

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë paratë në dorë, depozitat e mbajtura në bankë dhe investime të tjera afatshkurtra me likuiditet të lartë me maturime origjinale prej tre muajsh ose më pak.

2.2.2 Njohja e te hyrave

Të hyrat njihen si të ardhura në periudhën kur paguhen. Në fund të vitit sasia e tepërt e të hyrave krahas shpenzimeve trajtohen si bilanc i bartur në periudhën e ardhshme.

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

2.2.3 Grantet

Grantet e Qeverisë njihen në fitim ose humbje në baza sistematike përgjatë periudhës në të cilën Organizata i njeh si shpenzime kostot përkatëse për të cilat grantet janë destinuar për kompensim. Në mënyrë specifike grantet e Qeverisë, për të cilat kushti primar është që Organizata duhet të i përfitoj, konstruktoj apo të i njeh pasuritë jo-qarkulluese si të hyra të shtyra në pasqyrën e pozitës financiare dhe të transferohen në fitim apo humbje në baza sistematike dhe racionale përgjatë jetës së përdorimit të pasurisë përkatëse.

Grantet janë njohur vetëm kur ka siguri të arsyeshme se:

- Organizata do të përmbushë të gjitha kushtet e bashkangjitura atyre; dhe
- Grantet do të pranohen.

Grantet operative janë njohur si e hyrë përgjatë periudhës së nevojshme për ti lidhur ato me kostot, për të cilat janë menduar të kompensohen, në bazë sistematike. Grantet e shënuara për përvetësimin e pasurive janë shtyrë dhe njohur si e hyrë përgjatë kohës së përdorimit të pasurisë përkatëse.

2.2.4 Shpenzimet

Shpenzimet e ndodhura janë njohur në periudhën përkatëse në baza të keshit.

2.2.5 Provizionet dhe detyrimet e papritura (kontingjente)

Detyrimet e papritura nuk janë njohur në pasqyrat financiare. Ato janë shpalosur vetëm nëse mundësia e rrjedhës së burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Aseti kontingjent nuk është njohur në pasqyrat financiare por është shpalosur kur rrjedhja e përfitimeve ekonomike është e mundshme.

3. PARAJA DHE EKVIVALENTËT E PARASË

Paraja dhe ekuivalentët e parasë	31 dhjetor 2024 €	31 dhjetor 2023 €
Paraja ne bankë - BKT 137	-	59,855
Paraja ne bankë - BKT 889	-	18,107
Paraja ne bankë - BKT 986	-	9,548
Paraja ne bankë - BKT 404	-	500
Paraja ne bankë - BKT 113	2,329	302
Paraja ne bankë - BKT 792	634	233
Paraja ne bankë - BKT 695	-	-
Paraja ne bankë - BKT 598	-	-
Paraja ne bankë - BKT 210	67,607	-
Paraja në arkë	383	600
Total paraja dhe ekuivalentët e parasë	70,954	89,145

4. TË HYRAT E SHTYERA

Të hyrat e shtyera	31 dhjetor 2024 €	31 dhjetor 2023 €
Të hyrat e shtyera MKRS	-	59,855
Të hyrat e shtyera CARITAS	-	18,369
Të hyrat e shtyera CDF-SIDA	67,607	9,628
Të hyrat e shtyera EU ECP03/24	2,893	-
Të hyrat e shtyera KCSF/EJA	-	-
Të hyrat e shtyera FLOSK/UNDP Filigrani	-	-
Të hyrat e shtyera ATRC	-	-
Të hyrat e shtyera LUX	-	-
Të hyrat e shtyera KFOS	-	-
Të hyrat e shtyera UNDP	-	-
Të hyrat e shtyera nga projektet e vogla	454	1,294
Total të hyrat e shtyera	70,954	89,146

5. TË HYRAT NGA DONACIONET

Të hyrat nga donacionet	31 dhjetor 2024 €	31 dhjetor 2023 €
Të hyrat nga CDF SIDA	124,323	81,970
Të hyrat nga MKRS	82,000	80,000
Të hyrat nga Caritas	50,251	44,298
Të hyrat nga KCSF/EJA	-	38,300
Të hyrat nga UNDP	-	19,156
Të hyrat nga GIZ 2	-	15,816
Të hyrat nga DKRS	-	900
Të hyrat nga GAP Institute	290	900
Të hyrat nga EU ECP03/24	6,887	-
Të hyrat nga OPIC	15,312	-
Të hyrat nga MKRS	59,869	-
Të hyrat nga D4D ECP04/23	900	-
Të hyrat e shtyera nga viti i kaluar	-	84,088
Të hyrat e shtyera	-	-89,147
Total të hyrat nga donacionet	339,831	276,281

6. SHPENZIMET E PROJEKTIT

Shpenzimet e projektit	31 dhjetor 2024 €	31 dhjetor 2023 €
Shpenzimet për CDF SIDA	62,902	71,324
Shpenzimet për KCSF/EJA	-	32,177
Shpenzimet për Caritas	41,754	31,249
Shpenzimet për UNDP	897	22,502
Shpenzimet për GIZ 2	-	15,809
Shpenzimet për MKRS	114,319	11,431
Shpenzimet për GIZ	-	2,836
Shpenzimet për DKRS	-	388
Shpenzimet për EU ECP03/24	5,502	-
Shpenzimet për OPIC	14,491	-
Total shpenzimet e projektit	239,865	187,716

7. SHPENZIMET E PAGAVE

Shpenzimet e pagave	31 dhjetor 2024 €	31 dhjetor 2023 €
Shpenzimet për CDF SIDA	50,345	28,098
Shpenzimet për KCSF/EJA	-	19,215
Shpenzimet për Caritas	7,092	9,456
Shpenzimet për MKRS	23,460	8,700
Shpenzimet për UNDP	-	5,800
Total shpenzimet e pagave	80,897	71,269

8. SHPENZIMET ADMINISTRATIVE

Shpenzimet administrative	31 dhjetor 2024 €	31 dhjetor 2023 €
Shpenzimet për CDF SIDA	3,647	1,947
Shpenzimet për KCSF/EJA	-	1,688
Shpenzimet për GAP Institute	21	1,504
Shpenzimet për D+	799	1,113
Shpenzimet për UNDP	-	1,001
Shpenzimet për Civikos	-	645
Shpenzimet për Caritas	1,404	538
Shpenzimet për CoE	-	64
Shpenzimet për GIZ	924	-
Shpenzimet për MKRS	242	-
Total shpenzimet administrative	7,037	8,500

9. SHPENZIMET E QIRASË

Shpenzimet e qirasë	31 dhjetor 2024 €	31 dhjetor 2023 €
Shpenzimet për KCSF/EJA	-	2,400
Shpenzimet për UNDP	-	2,000
Shpenzimet për SIDA	5,580	1,650
Shpenzimet për D+	-	900
Shpenzimet për Civikos	-	185
Shpenzimet për MKRS 2024	1,750	-
Shpenzimet për EU ECP03/24	315	-
Total shpenzimet e qirasë	7,645	7,135

10. PROVIZIONET

Provizionet	31 dhjetor 2024 €	31 dhjetor 2023 €
Provizionet për CoE	233	228
Provizionet për CDF SIDA	-	216
Provizionet për KCSF/EJA	-	140
Provizionet për GAP Institute	269	74
Provizionet për D+	3	73
Provizionet për UNDP	-	39
Provizionet për DKRS	-	13
Provizionet për GIZ 2	-	11
Provizionet për Civikos	-	5
Provizionet për GIZ	-	4
Provizionet për MKRS	98	-
Provizionet për EU ECP03/24	146	-
Provizionet për OPIC	22	-
Total provizionet	770	803

11 KONTIGJENCAT DHE ZOTIMET

11.1. çështjet ligjore

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2024 organizata nuk ka ndonjë detyrim kontingjent që kërkon shpalosje në pasqyrat financiare të saj.

12 NGJARJET PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Nuk ka ngjarje domethënëse pas datës së raportimit që mund të kërkojnë rregullime ose shpalosje në pasqyrat financiare.